

LUTJE PËR CORONAVIRUS

Zot i tërëfuqishëm, ndihmues dhe shpëtim i botës,
shpërblyes dhe shpëtimtar i të sëmurëve,
mjek dhe përkrahës i atyreve që vuajnë,
shërues i hidhërimeve të trupave dhe të shpirtrave njerëzore,
që abolit vdekjen, Ti je Perëndia ynë.
Pra, Ty të lutemi tani, pastrona nga çdo lëngatë e trupit dhe e shpirtit.
O Zot, mos qëndro larg nesh.
Dërgo mbi ne fuqinë tënde qiellore të shërimit.
Largo prej nesh çdo sëmundje të fshehtë.
Jepna ndihmë në këtë kohë pandemie
dhe shpëtona nga çdo e keqe, vajtim dhe hidhërim.
Përfundo këtë epidemi dhe falna durim, o Zot.
Lartësona dhe bëhu mjek i të gjithëve,
ngrina nga shtrati i dhembjes dhe nga streset e vuajtjes.
Prano lutjet e doktorëve dhe të infermierëve
dhe të të gjithë atyre që shërbejnë dhe kujdesen për të sëmurët.
Ata ofrojnë, pra, përkujdesje dhe lehtësim
përmes dashurisë Tënde për njerëzimin.
dhe me fuqinë tënde forcoji.
Ndërsa ata që u epnë në këtë sëmundje dhe u ndanë prej nesh,
prehi në vend freskie,
sepse ata janë shërbëtorët e Tu dhe vëllezërit e motrat tona.
Na përtëri ne që kemi shpresë në Ty,
te Kisha Jote e shenjtë,
të shëruar dhe të shëndetshëm,
të të adhurojmë dhe të lavdërojmë emrin Tënd të shenjtë.
Se ti e ke në dorë të na mëshirosh dhe të na shpëtosh o Krisht Perëndia ynë
dhe Ty ta drejtojmë lavdinë
Atit e Birit edhe Shpirtit të shenjtë tani e përherë e në jetë të jetëve. Amin